

detyrim. Për më shumë me subjektin politik në fjalë, nuk më lidh asnjë raport politik e aq më pak juridik, madje e konsideroj një subjekt politik me interesa politiko elektorale tërësisht të ndryshme dhe pa asnjë interferim me subjektin politik në të cilin kam aderuar tani e në vazhdim.

Nën dritën e fakteve të mësipërme, neni 490 i Kodit të Procedurës Civile në pikën 1 të tij përcakton të drejtën e rekursuesit për të hequr dorë nga rekursi. Nga formulimi i pikës 1 të nenit 490 rezulton se e drejta e palës që ka ushtruar rekurs për t'u tërhequr nga shqyrtimi i këtij të fundit në seancë gjyqësore kushtëzohet vetëm nga elementi procedural sipas të cilit kjo kërkesë nuk mund të ushtrohet kur Kolegji Civil apo Kolegjet e Bashkuara është/janë tërhequr për vendim.

Në kushtet e mospërbushjes së kriterit mohues/ kufizues po Ju parashtoj kërkesën për heqjen dorë si më poshtë vijon:

Në kushtet kur në cilësinë e palës rekursuese pranë kësaj gjykate kam depozituar rekursin për çështjen me numër regjistri 90600-00442-00-2024, datë regjistrimi 30.07.2024 në kuptim dhe mbështetje të nenit 490 pika 1, të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë paraqes kërkesë për heqjen dorë nga rekursi dhe pushimin e gjykimit të kësaj çështje.

Ky vullnet i imi, nuk prekludon të drejtën apo interesin e kujtdo tjetër, që nëse ka interes të mund të shtyjë përpara këtë proces gjyqësor, jashtë vullnetit tim!

Rekursues

Enkelejd Alibeaj



Av. Percepti D. Hoxha

